

**SUNVOLT sh.p.k.**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**



**PËRMBAJTJA:**

**FAQE**

**PASQYRAT FINANCIARE:**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

2

PASQYRA E PERFORMANCES

3

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

4

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

5

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

6-14



**SUNVOLT sh.p.k.**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2018**

|   | Shënime | 31 dhjetor 2018  |
|---|---------|------------------|
| <b>AKTIVET</b>                              |         |                  |
| <b>Aktive afatshkurtra</b>                  |         |                  |
| Mjete monetare                              | 4       | 33,447           |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura  | 5       | 10,000           |
| Të tjera llogari të arkëtueshme             | 6       | 112,857          |
| Inventari                                   | 7       | 360,461          |
| <b>Total aktive afatshkurtra</b>            |         | <b>516,765</b>   |
| <b>Aktivet afatgjata</b>                    |         |                  |
| <b>Total aktive afatgjata</b>               |         | -                |
| <b>Total aktive</b>                         |         | <b>516,765</b>   |
| <b>DETYRIMET</b>                            |         |                  |
| <b>Detyrime afatshkurtra</b>                |         |                  |
| Hua afatshkurtra                            | 8       | 3,158            |
| Llogari të pagueshme tregëtare              | 9       | 217,219          |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 10      | 133,267          |
| Detyrime tatimore                           | 11      | 6,696            |
| Të tjera detyrime                           | 12      | 712,000          |
| <b>Total detyrime afatshkurtra</b>          |         | <b>1,072,340</b> |
| <b>Detyrime afatgjata</b>                   |         | -                |
| <b>Total detyrime afatgjata</b>             |         | -                |
| <b>Totali i detyrimeve</b>                  |         | <b>1,072,340</b> |
| <b>KAPITALI</b>                             | 13      |                  |
| Kapitali i nënshkruar                       |         | 10,000           |
| Fitimi/humbja e vittit                      |         | (565,575)        |
| <b>Total kapitali</b>                       |         | <b>(555,575)</b> |
| <b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>    |         | <b>516,765</b>   |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënlimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**SUNVOLT sh.p.k.**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

|  | Shënimë | Për vitin e mbyllur më<br>31 dhjetor 2018 |
|--|---------|---|
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit                              | 14      | 6,124                                     |
| <b>Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme</b>                |         | <b>(354,479)</b>                          |
| 1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme                    |         | -   |
| 2) Të tjera shpenzime  | 15      | (354,479)                                 |
| <b>Shpenzime të personelit</b>                                   |         | <b>(217,062)</b>                          |
| 1) Paga dhe shpërblime   |         | (186,000)                                 |
| 2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore                 |         | (31,062)                                  |
| <b>Shpenzime financiare</b>                                      |         | <b>(158)</b>                              |
| 1) Shpenzime interesit dhe shpenzime të ngjashme                 |         | (158)                                     |
| 2) Shpenzime të tjera financiare                                 |         | -   |
| <b>Fitimi/humbja para tatimit</b>                                |         | <b>(565,575)</b>                          |
| <b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>                           |         | -   |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin                        |         | -   |
| 2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë                          | 18      | -   |
| <b>Fitimi/humbja e vtit</b>                                      |         | <b>(565,575)</b>                          |
| <b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:</b>           |         | -   |
| <b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b> |         | <b>(565,575)</b>                          |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


**SUNVOLT sh.p.k.**  
(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Ndrysimeve në Kapital**  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

|  | Kapitali<br>akcionar | Rezerva Ligjore | Rezerva të tjera | Fitim/humbja e<br>vittit | Totali        |
|--|----------------------|-----------------|------------------|--------------------------|---------------|
| <b>Pozicioni finanziar i ridekluar më 8 maj 2018</b> |                      |                 |                  |                          |               |
| Fitimi / Humbja e vittit                             | -                    | -               | -                | -                        | -             |
| Lëvizjet përmes kapitalit                            |                      |                 |                  | (565,575)                | (565,575)     |
| Emitimi i kapitalit                                  | 10,000               |                 |                  |                          | -             |
| <b>Pozicioni finanziar më 31 dhjetor 2018</b>        |                      |                 |                  |                          |               |
|  | <b>10,000</b>        |                 |                  |                          |               |
|  |                      | -               | (565,575)        |                          | <b>10,000</b> |
|  |                      |                 |                  | (565,575)                | (565,575)     |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Sunvolt Sh.p.k. më 20 mars 2019 dhe janë firmosur si më poshtë:

  
**Z. Mario Carugji**  
Administrator

 **MAZARS**  
Mazars Shpk  
Pali "Bimaket",  
Nr.5, 10000 Prishtina, Albania  
Phone: +385 27 36 15  
www.mazars.al , info@mazars.al

**SUNVOLT sh.p.k.**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

|  | Shënimë | 31 dhjetor 2018 |
|--|---------|-----------------|
| <b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>                                |         |                 |
| Fitim / Humbja e viti  |         | (565,575)       |
| Shpenzimet financiare jomonetare   |         | (6,124)         |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi   |         |                 |
| Rënje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera                          |         | (112,857)       |
| Rënje/(rritje) në inventarë  |         | (360,461)       |
| Rritje/(rënje) në detyrimet e pagueshme  |         | 904,014         |
| Rritje/(rënje) në detyrime për punonjësit  |         | 165,168         |
| <b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>          |         | <b>24,165</b>   |
| <b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>      |         | -               |
| <b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>            |         | -               |
| <b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>      |         |                 |
| Hua të arkëtuara   |         | 3,158           |
| <b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>            |         | <b>3,158</b>    |
| <b>Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b> |         | <b>27,323</b>   |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 8 maj                      |         | -               |
| <b>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</b>              |         | 6,124           |
| <b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>          | 4       | <b>33,447</b>   |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**SUNVOLT sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
(Vlerat janë në Lekë)

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "SUNVOLT" sh.p.k. është themeluar më 03 maj 2018 dhe është regjistruar më 08 maj 2018 në Regjistrin e Shoqërlive me akt themelimi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është, projektimi, ndërtimi, instalimi, funksionimi dhe menaxhimi i impianteve të prodhimit të energjisë nga çdo burim, si dhe ofrimin e shërbimeve të integruara për ndërtimin dhe menaxhimin e mundshëm të masave për reduktimin e konsumit dhe si përfundim çdo aktivitet tjetër lidhur me nderhyrjet në fushen e shërbimeve dhe kursimin e energjisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Mario Caruggi.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L81708006P. Selia qendrore e saj është në: Njësia Bashkiake nr 5, rruga 'Emin Duraku', Pallati Blnjakët, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe moneda funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësimet dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në perludhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshtkuar më poshtë:

**SUNVOLT sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**2.5.2. Provizonet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Flimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

| <b>Kursi i këmbimit</b> | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|-------------------------|------------------------|
| Euro/LEK                | 123.42                 |
| USD/ LEK                | 107.82                 |

**3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financlarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç sic përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njoftueshme fillojnë instrumentat financiarë jo-derivativë maten sic përshkruhet më poshtë.

**SUNVOLT sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(Vlerat janë në Lekë)**

**3. Politikat kontabël (vazhdim)**

**3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

**Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

**Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

**Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njoftes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njoftura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

**Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

**Të tjera**

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

**Kapitali**

Kapitali njihet me vlerën nominale.

**SUNVOLT sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(Vlerat janë në Lekë)**

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

**Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e Inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e Inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

**3.4. Aktive afatgjata materiale**

*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të reallojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**SUNVOLT sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(Vlerat janë në Lekë)**

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)****iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë pér bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve                   | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|--|----------------------|---------------------|
| Ndërtesa                               | Vlera e mbetur       | 5%                  |
| Instalime teknike,makineri dhe pajisje | Vlera e mbetur       | 20%                 |
| Mjete Transporti                       | Vlera e mbetur       | 20%                 |
| Mobilje dhe pajisje zyre               | Vlera e mbetur       | 20%                 |
| Pajisje informatike                    | Vlera e mbetur       | 25%                 |
| Të tjera                               | Vlera e mbetur       | 20%                 |

**iv. Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet pér shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra pér sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të vëprimitarës së ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të Investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimitaritë financiare dhe investuese.

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vtit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vtit, duke aplikuar normat tatilem në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 0%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatilem. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatilem në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatilem.

Shoqëria nuk ka burim diferençash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

#### 3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale Janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksonin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### 3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjeter, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjeter. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënlime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënlime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provzion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**SUNVOLT sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                            | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|----------------------------|------------------------|
| Mjete monetare             |                        |
| Llogari rrjedhëse në bankë | 33,447                 |
| Mjete monetare ne arkë     | <b>33,447</b>          |

**5. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                                  | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|----------------------------------|------------------------|
| Kapitali i nenshkruar i papaguar | 10.000                 |
|                                  | <b>10.000</b>          |

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                                  | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|----------------------------------|------------------------|
| TVSH e kreditueshme              | 112,805                |
| Llogari dogane gjendje kreditore | 52                     |
|                                  | <b>112,857</b>         |

**7. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

|                   | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|-------------------|------------------------|
| Materiale të para | 360,461                |
|                   | <b>360,461</b>         |

**8. Hua afatshkurtra**

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                                  | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|----------------------------------|------------------------|
| Overdraft banka Intesa San Paolo | 3,158                  |
|                                  | <b>3,158</b>           |

**SUNVOLT sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(Vlerat janë në Lekë)**

**9. Llogari të pagueshme tregëtare**

Llogaritë e pagueshme tregëtare më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                   | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|-------------------|------------------------|
| Furnitorë vendas  | 44,431                 |
| Furnitorë të huaj | 172,788                |
|                   | <b>217,219</b>         |

**10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve e lidhura më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                                   | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|-----------------------------------|------------------------|
| Financim nga ortaku Mario Caruggi | 133,267                |
|                                   | <b>133,267</b>         |

**11. Detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|   | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|---|------------------------|
| Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 6,696                  |
|   | <b>6,696</b>           |

**12. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                                    | <b>31 dhjetor 2018</b> |
|------------------------------------|------------------------|
| Detyrime ndaj personelit           | 165,168                |
| Të tjera detyrime ndaj Mazars Shpk | 149,032                |
| Financim Gian Pietro Tumiati       | 203,643                |
| Financim nga MP Srl                | 123,808                |
| Financim Giordano Gorini           | 70,349                 |
|                                    | <b>712,000</b>         |

**13. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë SUNVOLT sh.p.k. është 10.000 lekë më 31 dhjetor 2018.  
Humbja e viti është 565,575 Lekë.

*[Handwritten signature]*

**SUNVOLT sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**14. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|  | <b>Për vitin e mbyllur më<br/>31 dhjetor 2018</b> |
|--|---|
| Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit | (1,459)   |
| Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit  | 7,583   |
|  | <b>6,124</b>                                      |

**15. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet të tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

|                                | <b>Për vitin e mbyllur më<br/>31 dhjetor 2018</b> |
|--------------------------------|---|
| Shpenzime administrative       | 57,330  |
| Shpenzime konsulencë ekonomike | 149,609   |
| Shpenzime bankare              | 16,206  |
| Taksa vendore                  | 131,334   |
|                                | <b>354,479</b>                                    |

**16. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

|   | <b>Për vitin e mbyllur më<br/>31 dhjetor 2018</b> |
|---|---|
| Shpenzime per pagë                                | 186,000   |
| Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 31,062  |
|   | <b>217,062</b>                                    |

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

**17. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

|                        | <b>Për vitin e mbyllur më<br/>31 dhjetor 2018</b> |
|------------------------|---|
| Shpenzime për interesa | (158)   |
|                        | <b>(158)</b>                                      |

**SUNVOLT sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(Vlerat janë në Lekë)**

**18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

|   | <b>Për vitin e mbyllur më<br/>31 dhjetor 2018</b> |
|---|---|
| <b>Fitimi para tatimit</b>                                    | <b>(565,575)</b>                                  |
| Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)                | -   |
| <b>Fitimi para tatimit (perfshirë shpenzimet e panjohura)</b> | <b>(565,575)</b>                                  |
| Tatim fitimi 0%   | -   |
|   | <b>(565,575)</b>                                  |

**19. Angazhime dhe pasiguri**

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin finanziar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

**20. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.